



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN
Nr. / Nr. 105/16
Nr. / Nr. / Br. Nr.
Data / Datum 01.02.2016
VUSHTRRI - VUČITRAN



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit- Komuna e Vushtrrisë

Vendi i punës: Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me legalizimin e objekteve

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj, pa mundësi vazhdimi)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 321.36 euro

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i mbështetjes teknike dhe profesionale për punën rreth legalizimit të objekteve;

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësitë;

- Inspektimi i dokumentacionit (verifikimi i tërësishëm i dokumentacionit me të cilin ka aplikuar për legalizimin e objektit);
- Inspektimi vizual (verifikimi në ortofoto, lokacioni i ndërtimit, lidhja me infrastrukturë, kategoria e tokës, rreziku për përmytje-stabiliteti i objektit, rrezikimi i shtretërve të lumit, rrezikimi gjeologjik, rrezikimi për tejkalim të ndotjes së mjedisit, plotësimi i kërkesave themelore minimale të shëndetit dhe sigurisë për legalizim, etj.);
- Vendimi për legalizimin ose refuzimin e legalizimit të ndërtimit pa leje;

Kualifikimi profesional, aftësitë, përgjegjësitë:

Diplomë universitare nga lëmi: Inxhinier ndërtimtarisë, Arkitekturës, Hidroteknikës, Gjeodezisë Teknologjisë Informative, Jurist, Ekonomist.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. 028-572-416.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku